



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I GJEOLOGJISË DHE I MINIERAVE
DEKANATI



LAJMËRIM

Lajmërojmë të gjithë studentët e interesuar se Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minerave ofron këto programe studimit të Nivelit të Dytë për vitin akademik 2023-2024:

I. MASTER SHKENCOR

A. Në Inxhinieri Gjeologjike, me profile:	KUOTA
Gjeoinformatikë	25
B. Në Inxhinierinë e Burimeve Minerare, me profile:	
Inxhinieri Miniere dhe Markshajderi	15
Pasurimi i Mineraleve dhe Riciklimi i Mbetjeve	15
C. Në Inxhinierinë e Naftës dhe Gazit	14
D. Në Inxhinieri Gjeomjedisi	29

II. MASTER PROFESIONAL

A. Në Inxhinieri Gjeologjike, me profile:	
Gjeoinformatikë	25
Gjeologji Inxhinierike & Hidrogjeologji	20
Gjeologji e Vendburimeve Hidrokarbure	20
Vendburimet e Mineraleve të Dobishme-Petrologji	20
B. Në Inxhinieria e Burimeve Minerare, me profile:	
Gjeomatikë	22
Inxhinieri Miniere	20
Pasurimi i Mineraleve dhe Riciklimi i Mbetjeve	15
C. Në Inxhinierinë e Naftës dhe Gazit	24
D. Në Inxhinieri Gjeomjedisi	30

Kanë të drejtë të aplikojnë për MASTER kandidatët që (Udhëzimi i MAS nr. 12, datë 30.06.2023, Kreu VII, pika 9):

1. Kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomë përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, në një program të ciklit të parë, i cili rezulton i licencuar në momentin e regjistrimit të studentit dhe akredituar para diplomimit të studentit, ose;
2. Janë diplomuar jashtë vendit në një institucion të arsimit të lartë ose institucion tjetër të autorizuar të huaj, të akredituar, për një program studimi të ciklit të parë, të akredituar. Në rast pranimit kandidati është i detyruar të kryejë njohjen dhe njehsimin e diplomës pranë QSHA-së, sipas afateve të përcaktuara në udhëzimi i MAS nr. 12, datë 30.06.2023;



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I GJEOLGJISË DHE I MINIERAVE
DEKANATI



I. KRITERET PËR MASTER I SHKENCAVE:

1. Në Programet e Studimit “Master i Shkencave” regjistrohen kandidatët që plotësojnë kriterin e notës mesatare të ponderuar të diplomës Bachelor, e cila propozohet çdo vit nga departamentet përkatëse dhe miratohet nga dekanati i fakultetit, mbi bazën e numrit të studentëve aplikantë dhe rezultateve të arritura prej tyre. ***Me vendimin Nr.5 dt. 22. 09. 2023 të Dekanit të FGJM, nota mesatare të ponderuar të diplomës Bachelor, si kriter hyrës në Programet e Studimit Master i Shkencave për vitin akademik 2023 – 2024 preferohet të jetë më e madhe ose e barabartë me 6.5 (gjashtë pikë pesë).***
2. Zotërojnë dëshminë e mbrojtjes së gjuhës së huaj (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht), në nivelin B1;
3. Numri i kuotave të ofruara dhe plotësimi i tyre sipas parimit “meritë-preferencë”;
4. Plotësimi i numrit minimal, 10 (dhjetë) studentë, si kusht për hapjen e programit përkatës të studimit;
5. Vazhdimësia e të njëjtit program studimi të ciklit të parë edhe në ciklin e dytë të studimeve, përbën përparësi.
6. Preferenca e studentit, për diplomën e zgjedhur dhe momenti i aplikimit nuk përbëjnë përparësi.

II. KRITERET PËR MASTER PROFESIONAL:

1. Numri i kuotave të ofruara dhe plotësimi i tyre, sipas parimit “meritë-preferencë”;
2. Plotësimi i numrit minimal, 10 (dhjetë) studentë, si kusht për hapjen e programit përkatës të studimit;
3. Vazhdimësia e të njëjtit program studimi të ciklit të parë edhe në ciklin e dytë të studimeve, përbën përparësi.
4. Preferenca e studentit, për diplomën e zgjedhur dhe momenti i aplikimit nuk përbëjnë përparësi.

DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR REGJISTRIM:

1. Kandidati paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij dhe dorëzon në Sekretarinë Mësimore të Fakultetit, dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) Diplomën dhe listën e notave/suplementin e diplomës, ose fotokopje të saj të njësuar me origjinalin, të ciklit të parë të studimeve të përfunduar në Republikën e Shqipërisë. Diplomë e ciklit të parë të studimeve të përfunduar jashtë vendit, të shoqëruar me fotokopje të diplomës të njësuar me origjinalin, ose, në mungesë të saj, të një dokumenti tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njohja dhe njehsimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet, që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve universitare të ciklit të dytë. Kandidatët që nuk e kanë përfunduar procesin e njohjes dhe njehsimit të diplomës, paraqesin vërtetimin që kanë aplikuar pranë QSHA për njohje dhe njehsim;
 - b) Formularin e aplikimit, sipas formatit të shtojcës nr. 2, pjesë përbërëse e Udhëzimit nr. 12, datë 30.06.2023;
 - c) Deklaratën sipas shtojcës nr. 1, pjesë përbërëse e Udhëzimit nr. 12, datë 30.06.2023;
 - d) Kopjen e dokumentit të identifikimit;
 - e) Dy fotografi personale.



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I GJEOLGJISË DHE I MINIERAVE
DEKANATI



- f) Dëshminë e njohjes së gjuhës shqipe, lëshuar nga strukturat përgjegjëse, vetëm për shtetasin e huaj i cili regjistrohet në një program studimi që zhvillohet në gjuhën shqipe. Kandidati që ka kombësi shqiptare dhe njohuri të gjuhës shqipe, mund të paraqesë çdo dokument nga vendi i origjinës që provon njohjen e kësaj gjuhe. Nga ky detyrim përjashtohen shtetasit e huaj që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë ose program studimi në gjuhën shqipe në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.
- g) Dëshmia e gjuhës së huaj, vetëm për aplikantët për Master Shkencor.

Aplikimi dhe regjistrimi pranë Sekretarisë Mësimore të Fakultetit, në zbatim të shkresës së Rektorit nr. 21177/1, datë 26.09.2023, do të bëhet, çdo ditë, nga ora 8:00 deri në orën 17:00, sipas kalendarit të mëposhtëm:

1. Aplikimi: **deri në 04 Tetor 2023**
2. Shpallja e listave të kandidatëve që kanë aplikuar për transferim studimesh dhe ata që kanë aplikuar për program të dytë studime në vende të dukshme **deri në 06 Tetor 2023**
3. Shqyrtimi i aplikimeve dhe renditja e tyre nga Komisionet ad hoc, të ngritur pranë Departamenteve përkatëse: **Deri në 11 Tetor 2023**
4. Shpallja në web dhe në mjedise të dukshme e listës paraprake të aplikantëve fitues, të renditur sipas rendit zbritës brenda dt. **11 Tetor 2023**
5. Ankimimi nga aplikantët **11 – 12 Tetor 2023**
6. Shqyrtimi i ankimimeve **12 – 13 Tetor 2023**
7. Shpallja e listave përfundimtare të renditjes në web dhe mjediset e Fakultetit **14 Tetor 2023**
8. Regjistrimi i kandidatëve fitues, pranë Sekretarisë Mësimore të Fakultetit: **16÷20 Tetor 2023**
9. Shpallja e listës emërore të kandidatëve të regjistruar: **24 Tetor 2023**
10. Dërgimi në QSHA i listës së studentëve të regjistruar (format elektronik dhe letër), për pajisje me numër matricullimi: deri më **18.12.2019**